

Vendim nr. 331, datë 23.12.2025

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji, Kryetare

Sandër Beci, Anëtar

Sonila Bejtja, Anëtare

në datën 23.12.2025 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 9 (N) 2025 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: NIKOLL PEPA

OBJEKTI: Detyrimi i bankës që të më japë lekët e mia sipas mandatit të arkëtimit “Bono Privatizimi”.

BAZA LIGJORE: Neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sonila Bejtja, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi rezulton se ka paraqitur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë një padi me objekt “*Dhënien e bonove të privatizimit sipas një mandati arkëtimit*”. Kjo çështje është

gjykuar nga gjyqtarja A.P., e cila, me vendimin nr. 3719, datë 04.07.2022, ka vendosur kthimin e akteve kërkuesit për shkak se padia paraqitet me të meta. Sipas asaj gjykate, kërkesëpadia duhet të shoqërohet njëkohësisht me pagesën e taksës mbi aktet, provat në kopje të mjaftueshme për komunikimin e palëve ndërgjyqëse edhe aktet e përfaqësimit, urdhërime ligjore të sanksionuara në nenin 156 të Kodit të Procedurës Civile.

2. Më tej, kërkuesi ka paraqitur në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Shkallës së Parë*) aktin e titulluar “Kërkesëpadi”, duke kërkuar rigjykimin e padisë së paraqitur prej tij pranë kësaj gjykate dhe rigjykimi i saj të mos bëhej nga gjyqtarja A.P., për shkak se ajo gjyqtare në shqyrtimin e çështjes së tij ka mbajtur qëndrime të njëanshme dhe të pavërteta.

3. Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (*Prokuroria e Posaçme*), me vendimin e datës 19.03.2024, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, për kallëzimin penal nr. 55 të vitit 2024 të kërkuesit, duke arsyetuar se mënyra e zgjidhjes së një çështje konkrete nuk është objekt vlerësimi nga prokuroria dhe se Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka konkluduar se nuk ka shkelje disiplinore të veprimtaria e gjyqtarës në rastin e referuar. Vendimi i prokurorit i datës 19.03.2024 i është njoftuar kërkuesit me shkresën nr. K198/1 prot., datë 20.03.2024. Për këtë arsye, kërkuesi në datën 15.07.2024 i është drejtuar GJKKO-së së Shkallës së Parë duke kundërshtuar këtë vendim të Prokurorisë së Posaçme për mosfillimin e procedimit penal ndaj personit të kallëzuar prej tij.

4. GJKKO-ja e Shkallës së Parë, me vendimin me vendimin nr. 447, datë 04.09.2024, ka vendosur mospranimin e ankimit të kërkuesit ndaj vendimit të Prokurorisë së Posaçme për mosfillimin e procedimit, duke vlerësuar se ankimi ishte paraqitur jashtë afatit 10-ditor të parashikuar nga neni 291, pika 2, i Kodit të Procedurës Penale (*KPP*). Sipas asaj gjykate, nga aktet e paraqitura nga vetë kërkuesi provohet se ai ka marrë dijëni për vendimin e prokurorit jo më vonë se data 27.03.2024, ndërkohë ankimi ndaj këtij vendimi është paraqitur në gjykatë në datën 15.07.2024. Kundër këtij vendimi ka bërë ankim kërkuesi.

5. Gjykata e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Apelit*), me vendimin nr. 212 (97-2024-303), datë 24.10.2024, ka lënë në fuqi vendimin e GJKKO-së së Shkallës së Parë, me arsyetimin se ankimi objekt gjykimi nuk plotëson kushtet e formës dhe përmbajtjes për t’u marrë në shqyrtim dhe si i tillë është akt i pavlefshëm. Po ashtu, ajo gjykatë konstaton se i tillë paraqitet edhe ankimi i datës 15.07.2024 i kërkuesit ndaj vendimit të mosfillimit të procedimit, pasi në përmbajtjen e tij nuk ka asnjë shkak se pse kërkohet të cenohet vendimi i prokurorisë dhe se çfarë kërkohet nga gjykata. Në vlerësimin e saj, GJKKO-ja e Apelit pajtohet me arsyetimin e gjykatës së shkallës së parë për konstatimin e ushtrimit të

ankimit të kërkuarit pas kalimit të afatit ligjor të parashikuar nga neni 291 i KPP-së. Ndaj këtij vendimi ka bërë rekurs kërkuari.

6. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2025-874, datë 27.05.2025, ka vendosur mospranimin e rekursit, pasi nuk plotëson kushtet formale të parashikuara nga ligji procedural, pasi nuk është firmosur nga një mbrojtës sipas parashikimeve të nenit 435/2 të KPP-së, si dhe në përmbajtjen e tij rekursi i paraqitur nuk përmban asnjë shkak ligjor nga ato që parashikon pika 1 e nenit 432 të KPP-së për kundërshtimin e vendimit të GJKKO-së së Apelit.

7. Në datën 29.09.2025 kërkuari ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*), i cili, pasi është plotësuar sipas parashikimeve të nenit 27, pika 5, të Ligjit Organik të Gjykatës, është regjistruar në datën 29.10.2025.

II

Pretendimet e kërkuarit

8. **Kërkuari** ka pretenduar se kërkesa e tij drejtuar GJKKO-së së Shkallës së Parë është dorëzuar në këtë gjykatë në datën 24.03.2024, ndërsa në datën 15.07.2024 ai ka paraqitur një kërkesë të dytë, e cila është konsideruar si kërkesë fillestare dhe nuk është pranuar prej saj, duke u konsideruar si kërkesë e paraqitur jashtë afatit ligjor. Edhe pse vendimin e GJKKO-së së Shkallës së Parë e ka ankimuar në GJKKO-në e Apelit, duke i bashkëlidhur edhe kërkesën e datës 24.03.2024, të vulosur nga zyra e protokollit të asaj gjykate, kjo e fundit ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë. Të njëjtën gjë ka bërë edhe Gjykata e Lartë, e cila nuk ka pranuar rekursin e tij. Nëpërmjet kërkesës së paraqitur në këtë Gjykatë kërkuari pretendon nxjerrjen e një vendimi që të detyrojë bankën që të japë paratë e tij sipas mandat arkëtimit “Bono privatizimi”.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitetin e kërkuarit

9. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi

kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike efektive, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

10. Lidhur me legjitimitimin *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, individi duhet të provojë interesin e tij si në aspektin procedural, ashtu edhe në atë substancial (*shih vendimet nr. 65, datë 30.11.2023; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Në çështjen konkrete, kërkuesi ka kundërshtuar procesin gjyqësor penal që ka vendosur për mosfillimin e procedimit penal të regjistruar mbi kallëzimin penal të paraqitur nga ai. Për rrjedhojë, nga pikëpamja procedurale, kërkuesi e justifikon interesin e tij në çështjen e parashtruar, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor ku janë dhënë vendimet e kundërshtuara.

11. Për sa i përket aspektit substancial të legjitimitimit *ratione personae*, në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se individi, si subjekt i kushtëzuar, mund të bëjë ankim kushtetues individual vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij të drejtpërdrejtë, si dhe të tregojë se në çfarë mënyre ai është cenuar në të drejtat e tij kushtetuese, pra se është viktimë e një shkeljeje dhe se pasojat nga akti i kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe reale për të (*shih vendimet nr. 29, datë 16.04.2024; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, kërkuesi duhet të justifikojë interesin kushtetues për çështjen e parashtruar përpara Gjykatës, pra se cenimi i të drejtave themelore prej vendimeve gjyqësore të kundërshtuara është vetjak, i drejtpërdrejtë dhe real.

12. Në rastin konkret, Kolegji vëren se edhe pse kërkuesi ka pretenduar në Gjykatë detyrimin e bankës për të paguar paratë e tij sipas mandatit “Bono privatizimi”, në thelb ai ka kundërshtuar procesin gjyqësor në përfundim të të cilit është vendosur mosfillimi i procedimit penal dhe në këtë kuptim mosndjekja penale e personit të kallëzuar prej tij. Në lidhje me këtë gjykatat kanë arritur në përfundimin se ankimi ndaj vendimit të mosfillimit të procedimit, në përmbajtjen e tij, nuk ka asnjë shkak se pse kërkohet të cenohet vendimi i prokurorisë dhe se çfarë kërkohet nga gjykata dhe se ai është ushtruar nga kërkuesi pas kalimit të afatit ligjor të parashikuar nga neni 291 i KPP-së.

13. Për sa më lart, në thelb, pretendimet e kërkuesit kanë të bëjnë me paligjshmërinë e veprimeve të të kallëzuarës prej tij, ndaj në rrethanat e rastit konkret procesi penal duket se nuk mund të sjellë pasojat materiale që kërkuesi synon, por ai nuk e kushtëzon atë (kërkuesin) në përdorimin e mjeteve ligjore për mbrojtjen e të drejtave substanciale (civile) që ai pretendon se i janë shkelur. Nga ana tjetër, Kushtetuta dhe KEDNJ-ja nuk garantojnë të drejtën për të filluar

ndjekjen penale kundër personave të tretë ose për dënimin e tyre (*shih Renata Mckay-Kopecka kundër Polonisë, 2006*).

14. Në këto kushte, Kolegji evidenton se kallëzimi penal ndaj personave të tretë nuk është i mjaftueshëm për të justifikuar interesin e kërkuarit në çështjen kushtetuese të parashtruar, në kuptimin që vendimet dhe procesi i kundërshtuar të sjellin pasoja reale dhe të drejtpërdrejta në të drejtat dhe liritë themelore individuale të tij. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se kërkuari nuk legjitimohet *ratione personae*, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës.

15. Në përfundim, Kolegji vlerëson se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.